

Orges DRANÇOLLI

**HISTORIKU I RESTAURIMEVE TË XHAMIVE KLASIKE DHE
NEOKLASIKE NË KOSOVË**

Abstrakt:

Gjatë periudhës së sundimit osman në Kosovë u ndërtuan një numër i madh i objekteve arkitektonike të karakterit fetar, publik dhe privat. Studimi “Historiku i restaurimeve të xhamive klasike dhe neoklasike në Kosovë” shqyrton historikun e ndërhyrjeve si restauruese ashtu dhe konstruktive në njëmbëdhjetë xhami, monumente kulture, që në masë të madhe ende e ruajnë origjinalitetin e kohës së ndërtimit. Xhamitë kryesisht u ndërtuan në periudhën e artit klasik osman, por kemi dhe dy ndërtime të mëvonshme, përkatësisht shekullit XI, si rasti i Xhamisë së Jashar Pashës në Prishtinë dhe Emin Pashës në Prizren që i ruajnë karakteristikat arkitektonike të xhamive klasike me kube në Kosovë. Ndërhyrjet në objektet sakrale u realizuan në periudha të ndryshme. Kësisoj, në studim këto masa ndaj objekteve klasifikohen në tri faza të ndryshme. Faza e parë është periudha e sundimit osman, faza e dytë periudha e sundimit serb (1912-1999), ndërkaq faza e tretë trajton ndërhyrjet pas vitit 1999, përkatësisht gjatë administrimit ndërkombëtar dhe pas pavarësimit të Kosovës. Punimi ka për qëllim që të evidentojë të gjitha ndërhyrjet dhe ndryshimet në objektet sakrale, qofshin ato pozitive apo negative për objektin, duke paraqitur një pasqyrë të trajtimit të xhamive gjatë periudhave të ndryshme kohore. Studimi bazohet në vetë ndërtimet arkitektonike si burim primar i informacionit. Po ashtu, do të merret parasysh literatura relevante që flet për ndërtimet në fjalë, si dhe në fotodokumentacion.

Fjalë kyçe: *Kosovë, xhami, monument, arkitekturë, restaurim.*

Kur flasim për xhamitë klasike dhe neoklasike në Kosovë, duhet kuptuar se bëhet fjalë për objekte kulti islam të realizuara gjatë sundimit osman në Kosovë, përkatësisht gjatë shek. XV-XIX. Ndërtimet janë njëhapësinore dhe mbulohen me kube. Në skemën kompozicionale xhamitë klasike përbëhen nga salla e lutjeve, hajati apo portiku si dhe minarja me një sherefë. Nga veprat e realizuara gjatë shekujve të sundimit osman, kohës i mbijetuan vetëm njëmbëdhjetë sosh që ende ruajnë origjinalitetin. Shumë të tjera u shkatërruan apo me kohë pësuan ndryshime deri në atë masë sa që sot kanë humbur identitetin fillestar. Shkaqet e shkatërrimit dhe të degradimit të këtyre veprave arkitektonike janë të shumta. Duke filluar nga koha, shkaqet atmosferike, luftërat e deri te moskujdesja dhe neglizhenca institucionale e njerëzore.

Gjatë hulumtimeve dhe studimeve për realizimin e doktoratës “Xhamitë me kube në Kosovë”¹, vura re një mungesë të theksuar të historikut të restaurimeve të xhamive klasike. Studimi erdhi si pasojë e mungesës së një trajtimi serioz shkencor të këtij aspekti të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ndonëse, duhet të themi se ka publikime që trajtohen objekte specifike ku flitet edhe për restaurimin e monumentit. Me këtë rast duhet përmendim autorët: Fejaz Drançolli², Nada Kurotovic-Folic³, Abdullah Gërguri⁴, Roksanda Timotijević⁵ Zeynep Ahunbay⁶ etj. Studimet e autorëve

¹ Disertacioni “Xhamitë me kube në Kosovë”, është botuar në vitin 2023, nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”- Prishtinë.

² Fejaz Drançolli, “Xhamia e Hadumit në Gjakovë (Historiku, arkitektura dhe piktura)”, *Vjetar XVIII- XIX*, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1984, f. 37; Fejaz Drançolli, *Studim në lidhje me realizimin e projektit të konservim-restaurimit të Xhamisë Ramadanijee Llapit në Prishtinë*, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, 2009.

³ Nada Kurtović-Folić, “Studija o revitalizaciji Velike Čaršije u Đakovici - Studimi për rivitalizimin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë”, *Antikitetet e Kosovës - Starine Kosova VIII*, Prishtinë, 1987.

⁴ Abdullah Gërguri, “Konservimi dhe restaurimi i pikturave murale në xhaminë e Sofi Sinan Pashës në Prizren”, *Antikitetet e Kosovës XVIII*, Prishtinë, 1987.

⁵ Roksanda Timotijević, “Prizrenske džamije i njihove dekoracije”, *Starine Kosova Antikitetet të Kosovës- IX*, PZSK, EKMMK, Pristina, 1989-1990,

⁶ Zeynep Ahunbay, “Context of Hadum Mosque in Ottoman/Balkan Architecture”, *Heritage After War: The Hadum Mosque restoration*, Cultural Heritage Without Borders - Kosovo office report series No. 10/2007, Prishtina, 2007.

të sipërpërmendur krahas trajtimit të objekteve arkitektonike flasin edhe për restaurimet e tyre dhe ndërhyrjet si në strukturë po ashtu edhe në pikturën dekorative. Tutje duhet të përmendim revistën “*Restorasyon Yıllığı*”.⁷ Në numrin 13 të kësaj reviste prezantohen punime në lidhje me restaurimet e xhamive në Ballkan, ku mes tjerash jepen analiza të detajuara fizike, kimike, petrografike të gurëve dhe materialeve të përdorura gjatë restaurimit të xhamisë së Mbretit në Prishtinë⁸, si dhe projekti i konservimit të xhamisë së Çarshisë në Pejë.⁹

Në studim do të paraqitet një përmbledhje e përgjithshme e të gjitha restaurimeve dhe ndërhyrjeve në xhamitë klasike në Kosovë të realizuara që nga koha e ndërtimit. Meqenëse këto ndërhyrje në objektet e kultit islam shtrihen në një hapësirë të gjerë kohore, në studim do të klasifikohen në tri periudha të ndryshme. Ndërhyrjet gjatë periudhës së sundimit osman, gjatë periudhës së sundimit serb 1912-1999 si dhe pas luftës së fundit në Kosovë, përkatësisht pas vitit 1999 e deri më sot. Studimi kryesisht bazohet në vizitat studimore në terren dhe literaturën relevante. Meqenëse për shumë ndërhyrje nuk kemi studime të veçanta të kohës, për disa objekte do të shfrytëzohet fotodokumentacioni në dispozicion.

Ndërhyrjet gjatë periudhës osmane

Ndërhyrjet më të hershme në xhamitë klasike me kube në Kosovë datojnë qysh nga periudha e sundimit osman, përkatësisht nga shek. XVII dhe XVIII. Jo çdo herë, këto masa në objektet e kultit, kishin të bënin me restaurimin e objektit. Shpeshherë ndërhyrjet kishin të bënin me shtimin e anekseve apo pikturën murale. Me këtë rast vlen të përmendet Xhamia e

⁷ *Restorasyon Yıllığı - Restorasyon-Konservasyon-Arkeoloji ve Sanat Tarihi Yıllığı Yıl*, Sayı: 13, Vakı ar Genel Müdürlüğü İstanbul I. Bölge Müdürlüğü, İstanbul, 2016.

⁸ Uzm. Dr. Özden Ormancı Öztürk, Meriç Bakiler, “Priştina - Fatih Camii restorasyonunda kullanılan onarım malzemelerinin Özellikleri- Properties of the repairment materials used for restoration of the Fatih Mosque in Prishtina”, *Restorasyon Yıllığı - Restorasyon-Konservasyon-Arkeoloji ve Sanat Tarihi Yıllığı Yıl*, Sayı: 13, Vakı ar Genel Müdürlüğü İstanbul I. Bölge Müdürlüğü, İstanbul, 2016, 56-65.

⁹ Aynur Gökteş, Zahide Çiğdem Alas, “Kosova Fatih (Çarşı-Bayraklı) Camisi'nin projelendirme çalışmaları -The Projection Work of the Fatih (Çarşı-Bayraklı) Mosque in Kosovo”- *Restorasyon Yıllığı - Restorasyon-Konservasyon-Arkeoloji ve Sanat Tarihi Yıllığı Yıl*, Sayı: 13, Vakı ar Genel Müdürlüğü İstanbul I. Bölge Müdürlüğü, İstanbul, 2016, 86-101.

Llapit (1569-1570) në Prishtinë. Ky objekt sakral, fillimisht u ndërtua si mesxhid.¹⁰ Më vonë me ndërtimin e minares dhe minberit shndërrohet në xhami. Data e saktë e ndërtimit të minares nuk dihet, por pas studimit për projektin e konservimit dhe restaurimit të objektit supozohet se minarja së bashku me kubënë u ndërtua gjatë shek. XVIII¹¹. Ky fakt plotësohet tutje edhe me burimet e kohës që flasin për kuadrin fetar që shërbeu në Xhaminë Ramadanie gjatë shek. XVIII.¹² Kësisoj mund të supozojmë se objekti u shndërrua në xhami në shekullin në fjalë dhe ndërtimi i minares u realizua po në atë kohë.

Në shekullin XVII-XVIII ndërmerren masa restauruese në Xhaminë e Mbretit (1461-1462) në Prishtinë¹³ si dhe Xhaminë e Çarshisë (1389-1461-1462) në Prishtinë, saktësisht në vitin 1575¹⁴. Me këtë rast janë marrë masa për riparimin e xhamive në aspektin konstruktiv, por kemi edhe ndërhyrje në pikturën murale. Në vitin 1762 bëhet riparimi i minberit në Xhaminë e Sofi Sinan Pashës (1615) në Prizren.¹⁵

Shekujt pasues të sundimit osman (XIX-XX), dallohen me aktivitete të shtuara sa i përket ndërhyrjeve në xhamitë klasike në Kosovë. Këto vite karakterizohen me rindërtime, shtim të anekseve si dhe ndërhyrje në pikturën murale. Me këtë rast vlen të përmendet Xhamia e Jashar Pashës (XVI-1834) në Prishtinë. Sipas mbishkrimit mbi portën e xhamisë, objekti sakral u ndërtua në vitin 1834 me donacion të Jashar Pashës¹⁶. Megjithatë, ka mendime se xhamia u rrënua gjatë periudhës së pushtimit austro-hungarez 1683-1690 dhe

¹⁰ Mehmet Z. Ibrahimgil, Neval Konuk, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri I*, I. Cilt, Türk Tarih Kurumu Yayınları, Ankara, 2006, 488.

¹¹ Fejaz Drançolli, *Studim*.

¹² Agron Islami, *Areali i Kosovës në kohën osmane*, Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, 2024, 126.

¹³ BOA, 20/1481 (21 Za. 1309/16.06.1892); BOA, DH.MKT.357/27 (1312 L.05/01.04.1895); BOA, Y..PRK.MYD. 4/8 (1302 Ra. 04/22.12.1884); BOA, Y..PRK.UM. 23/79 (1309 C. 13/13.01.1892); Mehmet Z. Ibrahimgil, *Fatih Sultan Mehmed Camii*, Türk Tarih Kurumu Yurt Disindaki Türk Kultur Varliklari Envanteri, Evnanter Numarasi: KVE, KS, PR, 03-10, 19 Temmuz 2001; Ibrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, 413.

¹⁴ Agron Islami, *Areali i Kosovës*, 125.

¹⁵ Krista De Jonge, Nora Arapi, "National identity expressed through religious heritage – case of Sinan Pasha Mosque, in Prizren, Kosovo", Leuven, 2012, 12.

¹⁶ Ekrem Hakkı Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri Yugoslavya*, III Cild, 3. Kitab, Bilmen Basımevi, İstanbul, 1981, 160; Ibrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, f. 506 -507; Nimetullah Hafiz, Mucahit Asim, "Priştine Kitabeleri", *Çevren Dergisi*, sayı 79/80, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 80; Islami, *Areali i Kosovës*, 117.

se Jashar Pasha, në fakt, e rindërtoi xhaminë që ishte rrënuar paraprakisht. Në aspektin konstruktiv, përkatësisht strukturës së muratimit, në xhaminë në fjalë vërehen dy teknika të muratimit. Në pjesën e poshtme të sallës së lutjeve, hasim në përdorim të gurëve të papërpunuar të formave të ndryshme, që mund të supozojmë që i takojnë objektit paraprak. Ndërkaq, pjesa e sipërme e sallës së lutjeve, u realizua me gurë kuadratik të përpunuar, rrjedhimisht e realizuar në gjysmën e parë të shek. XIX¹⁷ (fig. 1).

Në shekullin XIX kemi ndërhyrje edhe në Xhaminë e Hasan Agës (1580-1581) në Rogovë të Hasit. Në mbishkrimin mbi mihrab ka të dhëna se xhamia u restaurua për herë të tretë nga Mehmet Aliu.¹⁸ Ky mbishkrim dëshmon qartë se objekti ka pasur një sërë intervenimesh. Sipas Machiel Kiel, në fazën fillestare xhamia mund të ketë pasur portik të hapur të mbuluar me pesë kube. Nuk përjashtohet mundësia që mund të ketë qenë portik i mbuluar me çati të mbuluar me plumb, si portiku i Xhamisë së Hadumit (1594-1595) në Gjakovë që iu shtua objektit në vitin 1844-1845¹⁹ (fig. 2). Ky supozim vjen për faktin se edhe Xhamia e Koxha Sinan Pashës (1580-1581) në Kaçanik, e ndërtuar po në gjysmën e dytë të shekullit XVI përkatësisht gjatë viteve 1580-1581, kishte portik me çati të mbuluar nga plumbi. Kësisoj te këto xhami të gjysmës së dytë të shekullit XVI, përfshi edhe atë të Llapit dhe fazës fillestare të Jashar Pashës, portiku i hapur ishte zgjedhje konstruktive funksionale e kohës për objektet në fjalë, duke fituar më shumë hapësirë në kuadër të xhamisë, për besimtarët gjithnjë në rritje gjatë kësaj periudhe.

Në periudhën e fundit të sundimit osman, përkatësisht gjatë sundimit të sulltan Abdylhamitit II, krahas riparimeve, mbulohet portiku i Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë.²⁰ Me këtë intervenim, në vend të portikut të hapur realizohet portiku dykatësh i mbyllur dhe i mbuluar me çati. Mund të

¹⁷ Orges Drançolli, *Xhamitë me kube në Kosovë*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2023, 138.

¹⁸ Nimetullah Hafiz, Machiel Kiel, “The Mosque of Kel Hasan Aga in the village of Rogova: An unknown monument of the 16th century in the Kosovo District”, *Studies on the Ottoman Architecture of the Balkans*, Variorum, Hampshire, 1990, 414-415.

¹⁹ Zeynep Ahunbay, “Ottoman architecture in Kosova and restoration of Hadum Mosque in Gjakovo (Dakovica)”, Center and peripheries in Ottoman architecture: Rediscovering a Balkan Heritage, Cultural Heritage Without Borders Report series No. 9/2010, Sarajavo, 2011, 111; Fejaz Drançolli, *Xhamia e Hadumit, Çarshia e Gjakovës - Hadum Mosque Bazaar in Gjakova*, IMM, Prishtinë 2007, 8.

²⁰ Ayverdi, *Avrupa 'da*, f. 158; İbrahimgil, Konuk, *Kosova 'da*, 493-494.

supozojmë që portiku i mbyllur dykatësh i mbuluar me tri kube i Xhamisë së Çarshisë në Pejë dhe mbyllja e katit të sipërm tek portiku i Xhamisë së Koxha Sinan Pashës u realizuan në këtë periudhë. Me këto ndërhyrje u fitua më shumë hapësirë në objektet e lartcekura. Megjithatë, duhet të theksojmë se në aspektin artistik, këto ndërhyrje degradoan ndërtimet sakrale.

Periudha e sundimit serb 1912-1999

Fundi i sundimit të Perandorisë Osmane dhe rënia e Kosovës nën sundimin serb, shënon një pikë kthese për objektet sakrale islame dhe profane në Kosovë që u ndërtuan gjatë sundimit osman. Për dallim nga periudha paraprake, gjatë kësaj kohe, ndërtimet në stilin osman ishin dytësore apo fare të rëndësishme për regjimet pasuese. Me raste ishin dhe cak i shkatërrimit sistematik dhe të qëllimshëm.²¹ Shembull e kemi shkatërrimin e lagjes “Arasta” dhe “Arasta e Çarshisë” në Prizren²², Çarshinë e Vjetër në Prishtinë²³, Xhaminë e Junus Efendiut apo Lluakaçit në Prishtinë (1551-1552)²⁴ që ishte e mbuluar me kube, shkatërrimin e portikut të Xhamisë së Sofi Sinan Pashës në Prizren²⁵ etj.

Ndërhyrjet e para me qëllim të mbrojtjes së objekteve u realizuan nga Enti Krahinor për Mbrojtje të Monumenteve të Kulturës dhe filluan në vitet e ‘60-ta. Në Xhaminë e Mbretit në Prishtinë në vitin 1961-1962 për përforcim të stabilitetit të objektit u ndërhy në shtyllat e portikut, ndërkaq në vitet 1964-

²¹ Orges Drançolli, “Destruction of old bazaars in Kosova”, *Historijski pogledi - Historical Views*, Vol. VI, No. 10, Center for Research of Modern and Contemporary History, Tuzla, 2023, 106-107, 109-112.

²² Esat Haskuka, *Ura, çarshia dhe lagja “Arasta”*, Prizren, 1999, 17.

²³ Christine Kohlert, “Zona historike urbane në kontekstin e menaxhimit urban”, *Heritage of Prishtina - Remained Heritage of Prishtina*, Cultura Heritage Without Borders, Prishtina, 2008, f. 21; Andrew Herscher, *Violence taking place: The architecture of the Kosovo Conflict*, Stanford University Press, Stanford, 2010, 24-25, 28, 30.

²⁴ Eliza Hoxha, “Prish-ti-na”, *Heritage of Prishtina - Remained Heritage of Prishtina*, Cultura Heritage Without Borders, Prishtina, 2008, 9-10.

²⁵ Islami, *Areali i Kosovës*, 128.

²⁵ Muhamed Shukriu, *Prizreni i lashtë, Morfologjia e ecursive për ruajtjen e kulturës materiale*, Prizren, 2001, 298. De Jonge, Arapi, *National identity*, 14.

1967 u rregullua pjesa e sipërme e minares.²⁶ Në vitin 1965, pas rinovimit të Xhamisë së Çarshisë në Pejë u bë hapja e portikut.²⁷

Gjatë viteve të '70-ta kemi ndërhyrje në Xhaminë e Sofi Sinan Pashës dhe Xhaminë e Emin Pashës (1832) në Prizren. Konkretisht në vitin 1972-1975 bëhet restaurimi dhe konservimi i pikturës në sallën e lutjeve të Xhamisë së Sinan Pashës.²⁸ Ndërkaq në Xhaminë e Emin Pashës në vitin 1974 me donacion të Bashkësisë së Fesë Islame në Prizren është bërë ngjyrosja e minares.²⁹ Po ashtu gjatë kësaj dekade, me qëllim të parandalimit të plasaritjeve në tamburin e kubesë së Xhamisë së Jashar Pashës në Prishtinë u vendos unaza metalike rreth tamburit.³⁰

Në vitin 1981 u kryen punime restauruese në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë.³¹ Ndërkaq në vitet 1993-1994, u rregulluan plasaritjet në kubënë qendrore si dhe masa konservuese të pikturës murale të Xhamisë së Gazi Mehmet Pashës në Prizren. Në qytetin e njëjtë në xhaminë e Emin Pashës në vitin 1985 vendoset një shtresë e plumbit në minare, ndërsa në vitin 1995 në portikun e xhamisë vendosen kornizat e qelqit të cilat nuk ishin në përputhshmëri me origjinalitetin e strukturës së ndërtimit të xhamisë.³² Në vitet '80-të dhe '90-të në Xhaminë e Jashar Pashës u bënë ndërhyrje në parmakët e sherefesë si dhe portikun e xhamisë, i cili u hap përsëri.³³ Gjatë shekullit XX kemi ndërhyrje në Xhaminë e Hasan Agës në Rogovë që degradojnë objektin si hajati dhe parahajati.³⁴ Këto shtesa nuk përshtaten

²⁶ Tefik Morina, "Monumentet e kulturës islame në Kosovë dhe mbrojtja e tyre gjatë periudhës 1945-1992", *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët (simposium ndërkombëtar)*, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, 519.

²⁷ Ayverdi *Avrupa'da*, 43; İbrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, 338.

²⁸ Agim Morina, Abdullah Gërguri 1931-1994, *Katalog i ekspozitës*, Prishtinë, 2014, f. 3; İbrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, 717.

²⁹ Shukriu, *Prizreni*, 328; İbrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, 582.

³⁰ Gani Gashi, *Xhamia e Jashar Pashës*, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Prishtinë, 2013.

³¹ Fejaz Drançolli, *Xhamia e Hadumit*, 37.

³² İbrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, 597.

³³ Gani Gashi, *Xhamia e Jashar Pashës*.

³⁴ Nimetullah Hafiz, Machiel Kiel, "The Mosque of Kel Hasan Aga in the village of Rogova: An unknown monument of the 16th century in the Kosovo District", *Studies on the Ottoman Architecture of the Balkans*, Variorum, Hampshire, 1990, 417-418; İbrahimgil, Konuk, *Kosova'da*, 413-414.

aspak me strukturën e xhamisë.³⁵ Në vitin 1981 dysHEMEJA e xhamisë mbulohet me dërrasa duke mbuluar dysHEMENË origjinale të shtruar me rasa guri.³⁶

Periudha e sundimit serb në Kosovë përfundoi me shkatërrimin masiv të trashëgimisë kulturore në Kosovë nga ana e forcave të sigurisë serbe. Ndër këto ndërtime fat të njëjtë pësuan edhe katër xhami klasike të mbuluara me kube, tri nga të cilat ishin të shpallura monumente kulture (Xhamia e Çarshisë në Pejë, Hadumit në Gjakovë, Hasan Agës në Rogovë të Hasit) si dhe Xhamia e Llapit në Prishtinë që ishte pjesë e trashëgimisë së evidentuar.

Restaurimet dhe ndërhyrjet pas vitit 2000

Periudha e pasluftës në Kosovë shënon pikë kthese sa i përket trajtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore të stilit osman të ndërtuara gjatë periudhës së sundimit osman në Kosovë. Lufta dhe fushatat shkatërruese të forcave të sigurisë të shtetit serb në Kosovë shkaktuan dëme të mëdha ndaj objekteve të kultit. Andaj nevoja për restaurime dhe ndërhyrje në objektet e trashëgimisë kulturore ishte e menjëhershme. Për dallim nga periudhat e mëhershme, në këtë fazë restaurimet, konservimet dhe ndërhyrjet në xhamitë e Kosovës u ndërmorën nga organizata të ndryshme nën mbikëqyrjen e institucioneve kosovare. Ndërhyrjet e para në xhamitë klasike u realizuan që në vitin 2000.

Objekti i parë që iu nënshtrua restaurimit është xhamia e Hadumit në Gjakovë. Restaurimi zgjati nga viti 2000 deri në vitin 2005. Fillimisht projekti u financua nga Instituti i Shkencave Njerëzore “Packard” dhe u realizua nga Projekti i Trashëgimisë Kulturore të Kosovës në SHBA. Ndërsa nga viti 2003, projekti u realizua dhe u përmbyll nga organizata CHwB³⁷. Paraportiku i mbuluar me çati është larguar, ndërkaq portiku ekzistent është i hapur i mbuluar me tri kube dhe ruan origjinalitetin e kohës së ndërtimit.

³⁵ Drançolli, *Xhamitë me kube*, 105.

³⁶ Shqipër Shala, *Rogova e Hasit nëpër shekuj: Fakte dhe dëshmi*, Shtëpia Botuese “Pjetër Bogdani”, Prizren, 2015, 133.

³⁷ Dick Sandberg, “Foreword”, *Heritage After War: The Hadum Mosque restoration*, Cultural Heritage Without Borders Kosovo office report series No. 10/2007, Prishtina, 2007, 7-8.

Në vitin 2001, u restaurua Xhamia e shkatërruar e Hasan Agës në Rogovë. Meqenëse xhamia ishte shkatërruar në masë të madhe gjatë luftës, ku disa elemente të saj janë konstruksione të reja.³⁸ Portiku dhe pjesa e sipërme e minares me beton arme u rindërtuan në vitin 2007-2008 me vetëfinancimin e banorëve të fshatit dhe BIK-ut.³⁹ Po ashtu minberi dhe galeria janë realizime të reja nga druri. Ndërkaq kubeja është mbuluar me llamarinë, e jo si në gjendjen origjinale që ishte me plumb, karakteristike për kubetë e xhamive të stilit osman.⁴⁰ Ndërkaq në vitin 2002 fillon restaurimi i Xhamisë së Çarshisë në Pejë, gjithashtu e djegur nga forcat serbe. Punimet restauruese i realizoi organizata italiane “Intersos”.⁴¹ Me këtë rast u restauruan elementet konstruktive e funksionale të xhamisë si mahfili apo galeria, mihrabi dhe minberi si dhe dekoracionet pikturale që ishin djegur gjatë luftës. Kjo xhami iu nënshtrua edhe një restaurimi të tërësishëm⁴² gjatë viteve 2018-2019 nga organizata turke “TIKA”. Pas këtij restaurimi në oborrin e xhamisë, në pjesën verilindore, është ndërtuar një shatërvan i ri.⁴³ Ndërkaq shatërvani i vjetër para hyrjes së xhamisë është larguar.⁴⁴ Po ashtu nga xhamia janë larguar alemët origjinalë të kohës dhe në vend të tyre janë vendosur alemë të rinj me forma të gjysmëhënës (fig. 3, 4). Sot, portiku i xhamisë është i mbuluar me tri kube dhe i mbyllur me xhama të tejdukshëm.

Në vitin 2000 pati ndërhyrje edhe në portikun e Xhamisë së Jashar Pashës, i cili u mbyll me konstruksion druri.⁴⁵ Në vitin 2015, realizohen ndërhyrje serioze në aspektin e rregullimeve konstruktive, arkitektonike dhe pikturale. Ndërhyrjet u realizuan nga “TIKA”. Duhet të cekim se pas kësaj ndërhyrjeje pikturës murale të xhamisë i janë shtuar motive të reja dekorative që nuk përkojnë me pikturën origjinale si dhe me raste janë përdorur ngjyra me tone të forta që nuk ishin karakteristike për xhaminë⁴⁶ (fig. 5, 6). Ndryshime të pikturës murale, përkatësisht dekoracionit në kalotën e kubesë,

³⁸ Ibrahimgil, Konuk, *Kosova 'da*, 41.

³⁹ Shala, *Rogova*, 135.

⁴⁰ Drançolli, *Xhamitë me kube*, 110, 111.

⁴¹ Ibrahimgil, Konuk, *Kosova 'da*, f. 338.

⁴² Göktaş, Çiğdem Alas, *Kosova Fatih (Çarşı-Bayraklı)*, 97-100.

⁴³ Po aty, 99.

⁴⁴ Drançolli, *Xhamitë me kube*, 79.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty, 45, 46

pati edhe gjatë restaurimit të Xhamisë së Mbretit në Prishtinë (fig. 7, 8). Restaurimi i tërësishëm në aspekt konstruktiv, arkitektonik e piktoral u realizua gjatë viteve 2009-2013. Me këtë rast bëhet edhe mbulimi i shatërvanit me kube.

Restaurime të përgjithshme u realizuan edhe në xhamitë tjera në Kosovë. Xhamia e Koxha Sinan Pashës u restaurua me donacion të qytetit të Bursës në vitin 2012. Me këtë rast, pas ndërhyrjeve, rikthehet portiku origjinal i mbuluar me tri kube si dhe me largimin e suvatimit rikthehet pamja origjinale e eksterierit të xhamisë. Në pjesën anësore të xhamisë, në anën e minares, janë larguar krojet me katër rubinete. Në vend të tyre është realizuar një shatërvan i ri që nuk i përgjigjet objektit.⁴⁷

Në vitin 2009 u bë restaurimi i tërësishëm i Xhamisë së Llapit në Prishtinë. Punimet u realizuan nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Me këtë rast bëhet pastrimi i ambientit nga ndërtimet pa kriter rreth xhamisë, hapja e portikut si dhe largimi i suvatimit, zbulimi i fasadës origjinale të objektit.⁴⁸ Në oborrin e xhamisë është realizuar shatërvani i ri që në gjendjen fillestare kishte vetëm një çezmë.⁴⁹

Dy xhamitë e Prizrenit (Xhamia e Sofi Sinan Pashës dhe Emin Pashës) iu nënshtruan restaurimeve të përgjithshme gjithashtu. Xhamia e Sofi Sinan Pashës u restaurua në vitin 2007-2011 me donacion të shtetit turk përkatësisht “TIKA”-s. Me këtë rast portiku i xhamisë rikthehet në gjendjen fillestare.⁵⁰ Po ashtu ambienti rreth xhamisë ruan origjinalitetin e kohës. Përjashtim bënë shatërvani i ri i ndërtuar në oborrin e xhamisë përkatësisht në pjesën verilindore. Ndërkaq, Xhamia e Emin Pashës u restaurua në vitin 2015, po ashtu nga organizata “TIKA”. Restaurimi i fundit i xhamive klasike u përfundua në vitin 2023. Bëhet fjalë për Xhaminë e Çarshisë në Prishtinë restaurimi i së cilës filloi që nga viti 2012. Përkundër problemeve të ndryshme që zvarritën procesin e restaurimit, mund të themi se punët u realizuan me sukses. Me këtë rast bëhet hapja e portikut dhe rikthimi në gjendjen origjinale në portik të hapur të mbuluar me tri kube. Po ashtu është larguar suvaja nga fasada e objektit dhe tashmë struktura origjinale e muratimit mund të shihet.

⁴⁷ Po aty, 121.

⁴⁸ Fejaz Drançolli, *Studim*.

⁴⁹ Drançolli, *Xhamitë me kube*, 91.

⁵⁰ De Jonge, Arapi, *National identity*, 22.

Tutje, janë vendosur rubinetet në shatërvanin e xhamisë duke e rikthyer atë në funksionin e tij primar. Me këtë rast, në shatërvan është vendosur dysHEMEJA si dhe janë shtuar tetë ulëse nga materiali i mermerit.

Trashëgimia kulturore materiale paraqet krijimtarinë e një populli në hapësirën ku ka jetuar dhe vepruar. Kësisoj, është tregues i nivelit të zhvillimit, kreativitetit të një populli dhe paraqet temelin e një shoqërie apo civilizimi. Për më shumë, është dëshmi e vazhdimësisë së jetesës dhe veprimtarisë së një populli në periudha të ndryshme historike. Andaj, kujdesi, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore është jetike për transmetimin e të kaluarës, traditës dhe memories kolektive tek brezat e rinjë.

Siç dhe u pa më lartë, historia e objekteve fetare, përkatësisht xhamive klasike me kube në Kosovë ishte gjithnjë aktive. Me kalimin e kohës ato pësuan restaurime, ndërhyrje dhe ndryshime të shumta. Këto ndërhyrje dhe ndryshime me raste ishin pozitive, por dhe negative për objektet. Kushtet klimatike, specifikisht lagështia ishte dhe vazhdon të jetë armiku kryesor i ndërtimeve sakrale, monumenteve në Kosovë. Por fatkeqësisht, gjatë shekullit XX, moskujdesi i duhur institucional dhe veçanërisht lufta e fundit ndikoj negativisht në shkatërrimin e kësaj trashëgimie kulturore e historike me vlera arti në Kosovë.

Nga ky studim mund të konkludojmë se secila nga tri fazat e lartë cekura kishte specifikat e saj sa i përketë ndikimit që la në këto ndërtime. Faza e parë, ajo e periudhës osmane, kryesisht karakterizohet me ndërhyrje në objekte me qëllim të përmirësimit të kushteve, hapësirave të objekteve, mirëmbajtjen e vakëfeve si dhe ndërhyrje në pikturën dekorative. Ndërhyrje gjithmonë u realizuan me leje nga institucionet Perandorisë Osmane me raste dhe të vet Sulltanit.

Faza e dytë, sundimit serb, karakterizohet me ndërhyrje të pjesëshme në objektet sakrale islame në Kosovë. Restaurimet dhe ndërhyrjet kryesisht u realizuan nga Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës por në pak raste edhe nga Bashkësia Islame e Kosovës. Mund të themi se gjatë kësaj periudhe xhamitë klasike me kube, edhe pse u shpallën monumente kulture dhe shteti ishte i obliguar të kujdesej për to, asnjëher nuk patën trajtim serioz dhe të dinjitetshëm. Madje, arti i stilit osman shpeshherë qëllimisht u neglizhua apo u shkatërrua nga institucionet shtetërore. Kjo periudhë

përfundon me shkatërrimin masiv të trashëgimisë kulturore përfshirë katër xhami klasike me kube nga frocat e sigurisë së shtetit serb.

Faza e tretë, periudha pas luftës, mund të themi se shënon fazën më të mirë sa i përket trajtimit të objekteve të kultit islam në Kosovë. Ndërhyrjet dhe masat restauruese ishin të shumta. Po ashtu për dallim nga dy fazat e mëhershme edhe donatorët ishin të shumtë dhe projektet dhe punët restauruese u realizuan nga organizata të ndryshme në bashkëpunim me institucionet vendore. Në shumicën e rasteve këto ndërhyrje ishin shumë të rëndësishme dhe pozitive për objektet në fjalë, megjithatë këto ndërhyrje me raste kanë mungesë profesionalizmi. Vëmendje dhe rëndësi më e tepërt duhet ti kushtohet elementeve dhe detjave karakteristike që i veçojnë xhamitë klasike me kube. Asesi nuk duhet lejuar të realizohen punime “shabllon”. Për këtë qëllim duhet pasur kujdes të shtuar nga institucionet e Kosovës gjatë pranimi të projekteve restauruese si dhe vigjilente në mbikqyrjen e punës gjatë realizmit të tyre. Kësisoj mund të evitohen disa problematika të shfaqura gjatë restaurimive të kohës së fundit.

Orges DRANÇOLLI

SUMMARY

THE HISTORY OF RESTORATIONS OF CLASSICAL AND NEOCLASSICAL MOSQUES IN KOSOVO

The paper discusses the significance of material cultural heritage as a reflection of a people's creativity and development in their living space. It emphasizes that cultural heritage is vital for transmitting the past, traditions, and collective memories to younger generations. The history of religious buildings in Kosovo, specifically classical mosques, is explored, noting their restorations and changes over time, which have sometimes been positive and other times negative. The text outlines three historical phases affecting these structures: Ottoman Period: Characterized by improvements in building conditions and decorative art, with all changes authorized by Ottoman institutions. Serbian Rule: Featured partial interventions in classical mosques, mainly by the Provincial Institute for the Protection of Cultural Monuments. During this time, traditional Islamic art was often neglected or destroyed, culminating in the mass destruction of cultural heritage, including several mosques. Post-War Period: Marked by significant restoration efforts and increased involvement from various donors and organizations.

While these interventions were generally positive, they sometimes lacked professionalism. The text calls for careful attention to the unique characteristics of classical mosques during restoration projects and advocates for vigilant oversight by local institutions to avoid past issues.



Fig. 1. Prishtinë. Xhamia e Jashar Pashës. Pamje e fasadës. (Orges Drançolli)



Fig. 2. Gjakovë. Xhamia e Hadumit. Portiku para shkatërrimit. (IKMM)



Fig. 3. Pejë. Xhamia e Çarshisë. Alemët origjinal. (Orges Drançolli)



Fig. 4. Pejë. Xhamia e Çarshisë. Alemi origjinal. (Orges Drançolli)




Fig. 5. Prishtinë. Xhamia e Jashar Pashës. Dekoracionet origjinale. (Afrim Hajrullahu)



Fig. 6. Prishtinë. Xhamia e Jashar Pashës. Dekoracionet e reja në enterierin e xhamisë. (Enis Imeri)




Fig. 7. Prishtinë. Xhamia e Madhe. Medaljoni në kube para restaurimit.
(IMKK)



Fig. 8. Prishtinë. Xhamia e Madhe. Medaljoni në kube pas restaurimit. (Enis Imeri)